



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 679 prot.

Fushë-Arrëz, më 5. 3. 2025

VENDIM

Nr. 9, datë 28. 02. 2025

**PËR NGRITJEN E NJË GRUPI PËRFAQËSUES NGA KËSHILLI BASHKIAK
FUSHË-ARRËZ QË DO TË MARRË PJESË NË TAKIMIN DYPALËSH ME
PËRFAQËSUES NGA SHA E UJËSJELLËSIT NË SHKODËR**

Bazuar në: Neni 54 pika a), Neni 55 pika 2, të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; "Rregulloren për funksionimin e Këshillit Bashkiak"; propozimin e Kryetarit të Këshillit të Bashkisë, bazuar në shqetësimet e gjithë komunitetit për problematikat që kanë me ujë të pijshëm dhe situatën e krijuar pas rritjes së çmimit dhe tarifave nga SHA e Ujësjetës në Shkodër " Të ngrihet një Grup Përfaqësues me anëtarë nga Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz dhe Kryetari i Bashkisë, i cili që do të marrë pjesë në takimin dypalësh me përfaqësues nga SHA e Ujësjetës në Shkodër", **Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz, në mbledhjen e datës 28.02.2025 pas diskutimeve,**

VENDOSI

Të ngrihet Grupi Përfaqësues me anëtarë nga Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz dhe Kryetari i Bashkisë, i cili që do të marrë pjesë në takimin dypalësh me përfaqësues nga SHA e Ujësjetës në Shkodër" me këtë përbërje:

1. **Hil Curri**, Kryetar i bashkisë
2. **Franc Doda** anëtar i KB njëkohësisht anëtar i Këshillit të Qarkut Shkodër
3. **Bardhok Qafa**, Zv/ Kryetar i KB
4. **Besjana Marku**, anëtare e KB

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë.

Ky vendim hy në fuqi bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 55 pika 6.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

11 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Zbardhur, më 5. 3. 2025.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

